

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: : **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**

Nr i Prokurimit **613-26-1500-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Renovimi i objektit te shkollës Vëllezërit Frashëri në Lipjan.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NNP''CTA''shpk&"HAJRUSH J, SHOSHI B.I.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr.Mehmet Gradica hy2 nr6

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+383-44-507719

(Numri Telefonit)

(Numri)

ZIJA MORINA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nnpcta@gmail.com

(Adresa elektronike)

16.09.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i objektit të shkollës Vëllezërit Frashëri në Lipjan”, me nr. të prokurimit **613-26-1500-5-2-1**, është publikuar në platformën e e-Prokurimit. Sipas B10, Njoftimi për Kontratë figuron me datë **26.03.2026**. Procedura është zhvilluar si **procedurë e hapur – punë**, ndërsa kriteri për dhënie ka qenë **çmimi më i ulët**.

05.06.2026 – AK publikon B58-në fillestare, me të cilën për kontratë rekomandohet GOE 3A Projekt SH.P.K. & EURO CONSTRUCTION NNP SH.P.K.

10.06.2026 – NOI CONSTRUCTION SH.P.K. paraqet Kërkesë për Rishqyrtim.

15.06.2026 – AK e aprovon pjesërisht kërkesën dhe e kthen aktivitetin në rivlerësim.

18.06.2026 – NOI CONSTRUCTION SH.P.K. paraqet ankesë në OSHP, nr. **2026/0395**.

22.06.2026 – publikohet B58 i ri, me të cilin për kontratë rekomandohet GOE NNP CTA SH.P.K. & Hajrush J. Shoshi B.I.–UNIKU.

20.07.2026 – pas rivlerësimit, AK anulon aktivitetin e prokurimit.

21.07.2026 – GOE NNP CTA SH.P.K. & Hajrush J. Shoshi B.I.–UNIKU paraqet Kërkesë për Rishqyrtim; më **24.07.2026** paraqitet ankesa në OSHP me nr. **2026/0523**.

08.09.2026 – OSHP, me Vendimin nr. **2026/0518 dhe 2026/0523**, aprovon si të bazuar ankesën e GOE NNP CTA SH.P.K. & Hajrush J. Shoshi B.I.–UNIKU, anulon vendimin e AK-së dhe e kthen aktivitetin në **rivlerësim**.

09.09.2026 – AK merr vendim për anulimin e aktivitetit dhe publikon Njoftimin për Anulim B10, duke u thirrur në arsyë të lidhura me Thesarin dhe vendime përmbarimore gjyqësore.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja është bërë në platformën eprokurimi

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Me datë **09.09.2026**, kemi parashtruar pranë Autoritetit Kontraktues – Komuna e Lipjanit **Kërkesë për Rishqyrtim** kundër vendimit dhe Njoftimit për Anulimin e aktivitetit të prokurimit me nr. **613-26-1500-5-2-1**, me titull “Renovimi i objektit të shkollës ‘Vëllezërit Frashëri’ në Lipjan”.

Deri më datë **16.09.2026**, Autoriteti Kontraktues nuk ka nxjerrë dhe nuk ka publikuar vendim lidhur me Kërkesën tonë për Rishqyrtim dhe, njëkohësisht, nuk jemi njoftuar për ndonjë zgjatje të afatit për shqyrtimin e saj.

Duke qenë se ka kaluar afati ligjor për vendimmarrje nga Autoriteti Kontraktues, në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe Rregullores për Prokurimin Publik, si dhe brenda afatit ligjor për ushtrimin e mjetit juridik, i drejtohem **OSHP-së me këtë ankesë kundër Njoftimit për Anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 09.09.2026 dhe mosnxjerrjes së vendimit nga Autoriteti Kontraktues lidhur me Kërkesën tonë për Rishqyrtim.**

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjate vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka zbatuar me përpikëri të gjitha dispozitat e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Përpos kësaj AK nuk ka respektuar as kërkesat e dosjes së tenderit të cilat vetë i ka parashtruar në fillim të këtij procesi të prokurimit. Dispozitat që ne mendojmë se AK i ka shkelur janë:

• Shkeljet e pretenduara:

LPP:

Neni **62.2.2**

Neni **131.**

Rregullorja Nr. 001/2022:

Neni **43.1,**

Neni **43.8(a),**

Neni **97.1(h)**

Neni **97.1(k).**

Vendimi i OSHP-së nr. 2026/0518 dhe 2026/0523, i datës 08.09.2026, me të cilin vendimi i AK-së është anuluar dhe aktiviteti është kthyer në rivlerësim, me udhëzime konkrete për veprim gjatë rivlerësimit.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Grupi i Operatorëve Ekonomikë **NNP CTA SH.P.K. dhe Hajrush J. Shoshi B.I.–UNIKU**, në cilësinë e palës së interesuar në aktivitetin e prokurimit me titull **“Renovimi i objektit të shkollës ‘Vëllezërit Frashëri’ në Lipjan”**, me nr. të prokurimit **613-26-1500-5-2-1**, në mbështetje të nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik, paraqet këtë **Kërkesë për Rishqyrtim** kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Lipjanit për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Kjo kërkesë paraqitet pas publikimit të **Njoftimit për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit – B10**, në të cilin data e vendimit për anulim është shënuar **09.09.2026**. Si bazë për anulim, Autoriteti Kontraktues është thirrur në rrethana objektive dhe të paparashikueshme jashtë kontrollit të tij, ndërsa në informacionet shtesë ka përmendur arsye të lidhura me **Thesarin dhe vendime përmbartimore gjyqësore**.

Anulimi i kundërshtuar është marrë vetëm një ditë pas Vendimit të Panelit Shqyrtues të OSHP-së nr. **2026/0518 dhe 2026/0523**, të datës **08.09.2026**, me të cilin ankesa e GOE NNP CTA SH.P.K. dhe Hajrush J. Shoshi B.I.–UNIKU është aprovuar si e bazuar, vendimi paraprak i Autoritetit Kontraktues është anuluar dhe aktiviteti është kthyer në **rivlerësim**.

Për këtë arsye, parashtruesi konsideron se vendimi i ri për anulim duhet t’i nënshtrohet shqyrtimit të plotë faktik dhe juridik, veçanërisht sa i përket **zbatimit të vendimit të OSHP-së, ekzistimit dhe demonstrimit të kushteve ligjore për anulim, gjendjes dhe disponueshmërisë së mjeteve financiare, lidhjes konkrete ndërmjet rrethanave të pretenduara financiare dhe këtij aktiviteti, si dhe respektimit të procedurës së përcaktuar për anulimin e aktivitetit të prokurimit**.

Në vijim paraqiten veçmas faktet, shkeljet e pretenduara dhe argumentet juridike mbi të cilat mbështetet kjo Kërkesë për Rishqyrtim.

PRETENDIMI NR. 1

Moszbatimi i Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0518 dhe 2026/0523

Me Vendimin nr. **2026/0518 dhe 2026/0523**, të datës **08.09.2026**, Paneli Shqyrtues i OSHP-së ka aprovuar si të bazuar ankesën e GOE NNP CTA SH.P.K. dhe Hajrush J. Shoshi B.I.–UNIKU, ka anuluar vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe aktivitetin e prokurimit e ka kthyer në **rivlerësim**.

Në arsyetimin e vendimit, Paneli ka përcaktuar qartë mënyrën se si AK duhet të veprojë gjatë rivlerësimit, duke kërkuar që Aneksi 8 të analizohet në tërësinë e tij dhe, në rast të paqartësive,

të zbatohen dispozitat për sqarimin e dokumentacionit. Paneli ka kërkuar gjithashtu që AK t'i zbatojë vendimet relevante në mënyrë të harmonizuar.

Megjithatë, më **09.09.2026**, vetëm një ditë pas nxjerrjes së Vendimit të OSHP-së, Autoriteti Kontraktues ka vendosur anulimin e aktivitetit të prokurimit, pa u dëshmuar se paraprakisht është zhvilluar rivlerësimi dhe janë zbatuar udhëzimet e dhëna nga Paneli Shqyrtues.

Vendimet e OSHP-së janë **detyruese për Autoritetin Kontraktues dhe duhet të zbatohen**. Mosrespektimi i vendimeve të OSHP-së përbën shkelje, ndërsa **neni 131 i LPP-së parasheh mundësinë e shqiptimit të gjobës ndaj Autoritetit Kontraktues në rast të mosrespektimit të vendimeve të OSHP-së**.

Për rrjedhojë, anulimi i aktivitetit menjëherë pas kthimit të tij në rivlerësim, pa u dëshmuar zbatimi i vendimit dhe i udhëzimeve konkrete të Panelit Shqyrtues, përbën **moszbatim të Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0518 dhe 2026/0523**.

Kërkohet që Pretendimi nr. 1 të aprovohet si i bazuar dhe Autoriteti Kontraktues të obligohet ta zbatojë Vendimin e OSHP-së dhe ta vazhdojë aktivitetin në rivlerësim në përputhje me konstatimet e Panelit Shqyrtues.

PRETENDIMI NR. 2

Mospërputhja ndërmjet arsyes së anulimit, fazës së procedurës dhe bazës juridike të përdorur nga AK

Rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit tregon se procedura kishte kaluar prej kohësh fazën e hapjes së tenderëve dhe ishte zhvilluar në disa faza të vlerësimit dhe rivlerësimit.

Fillimisht është nxjerrë B58 e datës **05.06.2026**. Ky vendim është anuluar nga vetë AK më **15.06.2026**, ndërsa aktiviteti është kthyer në rivlerësim. Pas përfundimit të këtij rivlerësimi, më **22.06.2026**, AK ka publikuar B58 të ri, me të cilin GOE NNP “CTA” SH.P.K. & “HAJRUSH J. SHOSHI” B.I.–UNIKU është rekomanduar për dhënien e kontratës. Vetë OSHP ka konstatuar se ky B58 ishte vendim i ri, i nxjerrë pas përfundimit të procesit të rivlerësimit dhe me rezultat të ri.

Më **20.07.2026**, pas një procesi tjetër të rivlerësimit, AK e ka anuluar aktivitetin. Mirëpo, në atë vendim arsyeja e anulimit **nuk ka qenë mungesa e mjeteve financiare apo veprimet e Thesarit**, por konstatimi se nuk kishte asnjë operator ekonomik të përgjegjshëm.

Ky vendim është shqyrtuar nga OSHP dhe, me Vendimin e datës **08.09.2026**, ankesa e GOE NNP “CTA” SH.P.K. & “HAJRUSH J. SHOSHI” B.I.–UNIKU është aprovuar si e bazuar, vendimi i AK-së është anuluar dhe aktiviteti është kthyer përsëri në rivlerësim.

Vetëm më **09.09.2026**, një ditë pas Vendimit të OSHP-së, AK e ka anuluar përsëri aktivitetin, këtë herë duke u thirrur në arsye të lidhura me **Thesarin dhe vendimet përmbartimore gjyqësore**. Sipas vetë B10-së, shkresa përkatëse nga ZKF ishte pranuar nga Zyra e Prokurimit më **13.08.2026**.

Megjithatë, ekzistimi i një shkrese apo i veprimeve të Thesarit nuk mjafton vetvetiu për anulimin e aktivitetit. AK duhet të dëshmojë se rrethana e pretenduar përputhet me **njërën nga bazat ligjore të lejuara për anulim në fazën konkrete në të cilën ndodhej procedura.**

Sipas **nenit 62.2.1 të LPP-së**, aktiviteti mund të përfundojë kur të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që tejkalojnë buxhetin e Autoritetit Kontraktues. Ndërsa **neni 62.2.2** lejon anulimin për shkak të ngjarjeve objektive, të demonstrueshme, jashtë kontrollit të AK-së dhe të paparashikueshme në kohën e inicimit, por shprehimisht **para hapjes së tenderëve dhe së paku tri (3) ditë para hapjes së tyre.**

Të njëjtën ndarje e përcakton edhe **neni 43 i Rregullores Nr. 001/2022**. Neni 43.5 përcakton rastet kur procedura duhet të anulohet pas hapjes së ofertave, përfshirë rastin kur një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të korrigjohet. Neni 43.7(a) lejon anulimin pas hapjes kur të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që tejkalojnë buxhetin e AK-së.

Në anën tjetër, **neni 43.8(a)**, në të cilin është mbështetur AK, i referohet ngjarjeve të demonstrueshme dhe të paparashikueshme **para hapjes së ofertave**, madje kërkon që anulimi të bëhet së paku tri ditë para hapjes.

Në rastin konkret është e pakontestueshme se më **09.09.2026** procedura nuk ndodhej para hapjes së ofertave. Tenderët ishin hapur, ishin vlerësuar dhe rivlerësuar disa herë, ishte rekomanduar operator për kontratë dhe aktiviteti sapo ishte kthyer nga OSHP në një rivlerësim tjetër.

Për këtë arsye, **neni 62.2.2 i LPP-së dhe neni 43.8(a) i Rregullores nuk përputhen me fazën faktike të kësaj procedure dhe nuk mund të shërbejnë si bazë juridike për anulimin e datës 09.09.2026.**

Edhe nëse AK dëshmon se kanë ekzistuar veprime konkrete të Thesarit, një fakt i tillë nuk e ndryshon kushtin e përcaktuar shprehimisht në nenin 62.2.2 dhe nenin 43.8(a), sipas të cilit kjo bazë aplikohet **para hapjes së tenderëve**. AK duhet të identifikojë dhe arsyetojë bazën ligjore që është e zbatueshme **pas hapjes së ofertave**, jo të përdorë një dispozitë që lidhet me një fazë të procedurës e cila kishte përfunduar muaj më parë.

Gjithashtu, sipas **nenit 43.1 të Rregullores**, në rast të anulimit AK duhet të publikojë B58 dhe në të të paraqesë **arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit**, ndërsa sipas nenit 43.2 Njoftimi për Anulim publikohet pas përfundimit të afateve për parashtrim dhe shqyrtim të mjeteve juridike.

Përfundimisht, pavarësisht nëse AK mund të dëshmojë ekzistimin e veprimeve të Thesarit, baza ligjore e përdorur për anulim duhet të përputhet me fazën në të cilën ndodhej procedura. Në rastin konkret, aktiviteti kishte kaluar prej kohësh fazën e hapjes së ofertave, ndërsa AK është mbështetur në dispozita që lejojnë anulimin për rrethana të paparashikueshme vetëm para hapjes së tenderëve. Për këtë arsye, vendimi i anulimit nuk është mbështetur në bazë juridike të zbatueshme për gjendjen faktike të procedurës.

Kërkohet që Pretendimi nr. 2 të aprovohet si i bazuar dhe vendimi i datës 09.09.2026 për anulimin e aktivitetit të anulohet.

PRETENDIMI NR. 3

Mungesa e arsytimit konkret dhe e provave që dëshmojnë domosdoshmërinë e anulimit

Në Njoftimin për Anulim – B10, Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se anulimi lidhet me një shkresë të Ministrisë së Financave drejtuar ZKF-së, me shkresën e pranuar nga Zyra e Prokurimit më **13.08.2026**, si dhe me arsye të Thesarit që burojnë nga vendime përmbarimore gjyqësore.

Megjithatë, nga arsyetimi i dhënë nuk rezulton se AK ka individualizuar dhe demonstruar konkretisht:

- cilat janë vendimet përmbarimore të cilave u referohet;
- kur janë nxjerrë dhe kur kanë filluar të prodhojnë efekt financiar;
- cilat mjete apo cili kod buxhetor i këtij aktiviteti është prekur;
- në çfarë mase janë prekur mjetet e destinuara për këtë projekt;
- pse ndikimi i pretenduar e bën objektivist të pamundur vazhdimin e pikërisht këtij aktiviteti të prokurimit.

Vetëm fakti se Zyra e Prokurimit ka pranuar një shkresë më **13.08.2026** nuk dëshmon se rrethana financiare ka lindur në atë datë, se ka qenë e paparashikueshme, apo se ajo e ka bërë të domosdoshëm anulimin e këtij aktiviteti.

Vetë **neni 62.2.2 i LPP-së**, në të cilin është thirrur AK, nuk mjaftohet me ekzistimin e një arsyeje të përgjithshme, por kërkon **ngjarje objektive dhe që mund të demonstrohen**, të cilat janë jashtë kontrollit të AK-së dhe të paparashikueshme në kohën e inicimit.

Prandaj, edhe sikur të merrej si i zbatueshëm ky nen, AK do të duhej të provonte në mënyrë kumulative jo vetëm ekzistimin e një veprimi të Thesarit, por edhe **karakterin e tij objektiv, kohën kur ka lindur, paparashikueshmërinë dhe lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet këtij veprimi dhe domosdoshmërisë së anulimit të aktivitetit konkret.**

Rëndësi ka edhe fakti se më **20.07.2026**, kur AK e kishte anuluar aktivitetin pas rivlerësimit, arsyeja e atëhershme nuk kishte qenë gjendja financiare apo veprimet e Thesarit, por pretendimi se nuk kishte operator ekonomik të përgjegjshëm. Pas anulimit të këtij vendimi nga OSHP më **08.09.2026**, AK vetëm një ditë më vonë ka paraqitur një arsye të re për anulim.

Kjo kronologji e bën edhe më të domosdoshëm një arsyetim të plotë dhe të verifikueshëm lidhur me atë se **kur ka lindur realisht pengesa financiare dhe pse ajo e ka bërë të pamundur vazhdimin e rivlerësimit të urdhëruar nga OSHP.**

Për më tepër, **neni 43.1 i Rregullores Nr. 001/2022** kërkon që, në rast të vendimit për anulim, në Formularin B58 të paraqiten **arsyet faktike dhe baza ligjore e anulimit**. Ky detyrim kërkon arsyetim konkret dhe të lidhur me aktivitetin përkatës, jo vetëm referim të përgjithshëm në shkresa institucionale apo vendime përmbarimore.

Përfundimisht, referimi i përgjithshëm në “arsye të Thesarit” dhe “vendime përmbarimore gjyqësore”, pa identifikuar dhe dëshmuar ndikimin konkret të tyre në këtë

aktivitetet dhe pa provuar se anulimi ishte domosdoshmëri e pashmangshme, nuk e përmbush standardin e një rrethane objektive dhe të demonstrueshme.

Për këto arsye, kërkohet që Pretendimi nr. 3 të aprovohet si i bazuar dhe vendimi i datës 09.09.2026 për anulimin e aktivitetit të anulohet.

PROVË SHITESË NË MBËSHTETJE TË PRETENDIMIT NR. 3

Në mbështetje të Pretendimit nr. 3, paraqesim si provë shtesë **Buxhetin e Kosovës për vitin 2026 – Tabela 4.2, Financimi i Investimeve Kapitale Komunale.**

Nga kjo tabelë rezulton se projekti “**Renovimi i objektit të shkollës Vëllezërit Frashëri në Lipjan**”, me kod të projektit **57115** dhe kod **613920-2648098**, është planifikuar për periudhën **04.2026–12.2027**. Për vitin **2026** janë paraparë **145,000.00 € nga Granti Qeveritar dhe 55,000.00 € nga të hyrat vetanake, gjithsej 200,000.00 €**, ndërsa për vitin **2027** janë paraparë edhe **50,000.00 €**, duke e çuar vlerën totale të projektit në **250,000.00 €**.

Kjo provë është relevante sepse në datën e anulimit, **09.09.2026**, projekti ka qenë ende brenda periudhës së planifikuar të realizimit **2026–2027**. Për rrjedhojë, edhe nëse AK pretendon se një pjesë e mjeteve është prekur nga Thesari apo nga vendime përmbarimore, AK duhet të dëshmojë konkretisht **cilat mjete janë prekur, në çfarë shume, cili kod buxhetor është afektuar dhe pse kjo e ka bërë objektivisht të pamundur vazhdimin e këtij projekti konkret.**

Për më tepër, Ligji i Buxhetit parashikon gjatë vitit fiskal 2026 regjistrimin e **transferimeve, rialokimeve dhe përshtatjeve të tjera të ndarjeve buxhetore**, prandaj ekzistimi i një ndikimi financiar nuk dëshmon vetvetiu se anulimi ka qenë e vetmja masë e mundshme.

Prandaj, kërkohet që OSHP ta administrojë këtë dokument si **provë shtesë në mbështetje të Pretendimit nr. 3** dhe t’i kërkojë AK-së të paraqesë dokumentacionin konkret që dëshmon ndikimin e pretenduar financiar në këtë projekt.

Provë: Buxheti i Kosovës për vitin 2026, Tabela 4.2 – Financimi i Investimeve Kapitale Komunale, **faqja 382/723 e PDF-së, përkatësisht Faqe 26/285 e Tabelës 4.2.**

Buxheti i Kosovës për vitin 2026
Tabela 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale

Organizata Buxhetore - Programi - Nën-Programi					Aprovuar për vitin 2026				Vlerësuara për				
Kodi Funk	Kodi i Prop	Kodi Proj	Data e Fillimit dhe Mbarimit	Emri i Projektit	Burimet E Fin.	Shpenz deri më 2025	Vazhdim nga 2025	Të reja për 2026	Totali 2026	Vitin 2027	Vitin 2028	Vitin >2029	Vlera Totale Projektit
						1	2	3	4=2+3	5	6	7	8=1+4+5+6+7
613920 - Arsime dhe Shkencë													
922500 - Arsime parashkollor													
0911	613920-2240109	51433	03.2027-12.2028	Ndërtimi i Qerdhës ne Banull-Gillogovc	GQ	0	0	0	0	310,000	150,000	0	460,000
0911	613920-2342632	53165	03.2027-12.2028	Ndërtimi i qerdhës ne Magure	GQ	0	0	0	0	310,000	150,000	0	460,000
0911	613920-2648091	57110	03.2028-12.2028	Ndërtimi i Qerdhës ne Lipjan	GQ	0	0	0	0	0	420,000	0	420,000
0911	613920-2648092	57111	03.2028-12.2028	Ndërtimi i Qerdhës ne Janjeve	GQ	0	0	0	0	0	200,000	0	200,000
0911	613920-2648093	57112	03.2028-12.2028	Ndërtimi i qerdhës ne Kraishte	GQ	0	0	0	0	0	320,000	0	320,000
0911	613920-2648096	57113	03.2026-09.2027	Ndërtimi i Qerdhës ne Dobraje të Madhe	GQ	0	0	110,000	110,000	160,000	0	0	270,000
					THV	0	0	100,000	100,000	0	0	0	100,000
				Totali (GQ) - Arsime parashkollor		0	0	110,000	110,000	780,000	1,240,000	0	2,130,000
				Totali (Te Hyrat Vetanake) - Arsime parashkollor		0	0	100,000	100,000	0	0	0	100,000
				Totali - Arsime Parafillor dhe Çerdhet - Lipjan		0	0	210,000	210,000	780,000	1,240,000	0	2,230,000
930600 - Arsime fillor, i mesëm i ulët													
0912	613920-2648097	57114	04.2027-12.2028	Ndërtimi i Shkolles ne Smalushë	GQ	0	0	0	0	150,000	220,000	0	370,000
0912	613920-2648098	57115	04.2026-12.2027	Renovimi i objektit te shkolles Vellezërit Frashëri ne Lipjan	GQ	0	0	145,000	145,000	50,000	0	0	195,000
					THV	0	0	55,000	55,000	0	0	0	55,000

PRETENDIMI NR. 4

Mosnxjerrja e vendimit nga Autoriteti Kontraktues brenda afatit ligjor

GOE NNP “CTA” SH.P.K. & “HAJRUSH J. SHOSHI” B.I.–UNIKU, më datë **09.09.2026**, ka parashtruar pranë Autoritetit Kontraktues – Komuna e Lipjanit Kërkesë për Rishqyrtim kundër vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me nr. **613-26-1500-5-2-1**, me titull “Renovimi i objektit të shkollës ‘Vëllezërit Frashëri’ në Lipjan”.

Sipas nenit **61.3 të Rregullores për Prokurimin Publik**, Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, është i obliguar ta shqyrtojë kërkesën për rishqyrtim brenda **tre (3) ditëve pune nga data e parashtrimit të kërkesës**. Ky afat mund të zgjatet, në raste specifike dhe të justifikuara, për jo më shumë se tri (3) ditë shtesë, me kusht që ankuesi të informohet për këtë zgjatje.

Në rastin konkret, deri më datë **16.09.2026**, Autoriteti Kontraktues nuk ka publikuar vendim lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim të parashtruar më 09.09.2026 dhe GOE nuk është njoftuar për ndonjë zgjatje të afatit për shqyrtimin e saj.

Sipas nenit **63.2 të Rregullores për Prokurimin Publik**, vendimi mbi refuzimin apo miratimin e kërkesës është obligativ dhe duhet të publikohet në sistemin e prokurimit elektronik. Në rast se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk nxjerr vendim dhe nuk e njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, operatori ekonomik ka të drejtë të parashtrtojë ankesë pranë OSHP-së pas skadimit të afatit prej tri (3) ditësh pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim.

KRPP ka sqaruar gjithashtu se, në rastet kur AK nuk ka nxjerrë vendim dhe nuk e ka njoftuar ankuesin për zgjatjen e afatit, afati për ushtrimin e ankesës në OSHP fillon të rrjedhë pas përfundimit të afatit të paraparë për kthimin e përgjigjes nga AK. KRPP ka theksuar se

moszbatimi i obligimit për nxjerrjen dhe publikimin e vendimit sipas nenit 63 të Rregullores klasifikohet si shkelje e rëndë.

Për rrjedhojë, mosnxjerrja dhe mospublikimi i vendimit lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim brenda afatit të përcaktuar ligjor përbën mosrespektim të detyrimeve procedurale të Autoritetit Kontraktues dhe nuk mund t’ia pamundësojë ankuesit ushtrimin e mjetit juridik pranë OSHP-së.

Kërkohet që ky pretendim të aprovohet si i bazuar dhe të konstatohet Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar brenda afatit ligjor për shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim të datës 09.09.2026.

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Ankesa e GOE NNP “CTA” SH.P.K. & “HAJRUSH J. SHOSHI B.I lidhur me tenderin **Renovimi i objektit te shkollës Vëllezërit Frashëri në Lipjan** me nrp: **613-26-1500-5-2-1**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e **Renovimi i objektit te shkollës Vëllezërit Frashëri në Lipjan** dhe lënda të kthehet në **RI-VLERËSIM**.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasojë e shkeljeve të pretenduara, Grupi ynë NNP “CTA” SH.P.K. & “HAJRUSH J. SHOSHI B.I. rrezikon humbjen e kontratës për të cilën ishte rekomanduar me B58-në e publikuar më 22.06.2026, si dhe humbjen e shpenzimeve të bëra për përgatitjen e ofertës, sigurimin e tenderit, angazhimin e stafit profesional dhe pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Ne i kemi bashkangjitur Ankesës tonë dokumentet e renditura më poshtë:

- Një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë”
- Një kopje të publikimit për “Njoftimi mbi Vendimin e AK”
-

Vërejtje: Të gjitha pretendimet tona mbështeten me fakte që i gjeni të bashkangjitura kësaj ankese por edhe në dokumentacionin e AK

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*